



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 26.12.2025
Numër Protokolli: 8129/2025

A.nr.1477/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1477/2025, të datës 25.0. 2025, të parashtruar nga ankuesi A.S, kundër organit të punësimit: Zyrës së Presidencës së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 6, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa numër A.nr.1477/2025, e datës 25.07.2025, e parashtruar nga ankuesi A.S.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil A.S (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 25.07.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos kompensimit të pagës sipas Aktit të Emërimit Nr. 34/2025 të datës 04.04.2025, në mënyrë retroaktive nga hyrja në fuqi Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr.03/2024 për Klasifikimin e Pozitave në Shërbimin Civil në Presidencë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka procedura kërkesën për përgjigje në ankesë tek Presidenca e Republikës së Kosovës, ndërsa kjo ka dërguar përgjigje në ankesë së bashku më provat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën më numër protokolli 5089/2025 të datës 25.07.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Akt Emërimit me Nr. 34/2025 të datës 04.04.2025; Vendimin me Nr. 19/2025 të datës 05.02.2025 për transferimin e ankuesit si rezultat i ristrukturimit; Përshkrimin e punës për pozitën Administrator i Teknologjisë Informative; Emailin e datës 24.09.2024 nga ankuesi për D.S; Kërkesën sipas emailit e datës 16.06.2025 nga ankuesi për T.P dhe D.S; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.08.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 12.08.2025; Emailin e datës 30.04.2025 nga T.P për A.T; Emailin e datës 24.04.2025 nga F.M për

G.B; Emailin e datës 23.04.2025 nga G.B për F.M; Konfirmimin e datës 08.04.2025; Formularin për ndryshime i datës 10.04.2025; Listën e pagave për ankuesin janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor dhe korrik 2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e parakohshme, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi është punësuar në Zyrën e Presidencës së Republikës së Kosovës, dhe se i njëjti fillimisht mbante pozitën Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme, ndërsa, bazuar në zbatimin e Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 03/2024 për Klasifikimin e Pozitave në Shërbimin Civil në Presidencë, më datë 05.02.2025 u.d Udhëheqësja e Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidencës së Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendim me Nr. 19/2025, me të cilin ankuesin e ka transferuar nga pozita Administrator i Lartë i TI-së për Sisteme në pozitën Administrator i Teknologjisë Informative dhe si rrjedhojë e kësaj më datë 04.04.2025, i është lëshuar Akt Emërimit me Nr. 34/2025, sipas klasës B5 dhe koeficientit të pagës 12.

Ankuesi më datë 16.06.2025, është drejtuar me kërkesë Udhëheqëses së Njesisë për Burime Njerëzore për sqarim lidhur me mos kompensimin e pagës sipas akt emërimit, mirëpo që nuk ka marr përgjigje, ndërsa, më datë 25.07.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se edhe përkundër faktit që akt emërimi i është lëshuar si një proces i ristrukturimit nuk i është bërë kompensimi sipas koeficientit të përcaktuar në akt emërim. Kërkon që ankesa të aprovohet, të obligohet Zyra e Presidencës së Republikës së Kosovës që të paguhet sipas akt emërimit të datës 04.04.2025 dhe të bëhet kompensimi në mënyrë retroaktive nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 03/2024 për Klasifikimin e Pozitave në Shërbimin Civil në Presidencë.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: “1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ...”* e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill më datë 25.07.2025 është e paraafatshme, pasi që ankuesit ende pa kaluar afati ligjor për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 16.06.2025 dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, mbi këtë bazë konstatimi, Kolegji vlerëson se ankesa e ankuesit është pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kontekst të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji thekson faktin se hedhja poshtë e ankesës A.nr.1477/2025, nuk nënkupton mohimin e së drejtës së ankueses që e njëjta serish të parashtroj kërkesë me bazë të njëjtë pranë organit të punësimit, e në rast të heshtjes se serishme administrative të këtij të fundit të ushtroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda afateve ligjore për heshtje dhe çdo herë duke respektuar afatet e parashkrimit të kërkesave të natyrës materiale sipas ligjit në fuqi të punës.

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi dispozitivit të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1477/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.S;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Zyrën e Presidencës së Republikës së Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.